

KËRKESË
Nr. 1169, datë 29.6.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “SAIMIR SHAHINI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: objekt i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2020 001362-5, datë 12.6.2020, për subjektin “Saimir Shahini”, me NIPT L61709035I, me adresë: Njësia Administrative nr. 5, rruga “Medar Shtylla”, zona “Komuna e Parisit”, pallati nr. 9, kati përdhes, dyqani nr. 3, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2020-001362-5

Datë 12.6.2020

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2020-001362-2, datë 12.6.2020, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Saimir Shahini”, me NIPT L61709035I, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Saimir Shahini” ID I51028002K, prej datës 12.6.2020 deri më datën 12.6.2020.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 12.6.2020 dhe e njoftoi në datën 12.6.2020. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe të sëmundjeve infektive”, akt normativ nr. 2, datë 11.3.2020, neni 7, pika 5.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe të sëmundjeve infektive”, neni 7, pika 5; neni 35, pika “C”, ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 11.3.2020, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 100 000 lekë;

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Bardhyl Poga ID_0401010004



Nardi Kasmi ID_0401070007



Personi i autorizuar i subjektit

Saimir Shahini ID I51028002K

Refuzim

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "Saimir Shabini" ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

